



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS
PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Shkurt 2024

Data 27.02.2024 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Projekt vendim për miratimin e dorëheqjes së anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.
- 2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2024.
- 3.Projekt vendim për miratimin e shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës të miratuar me VKB nr.91 datë 21.12.2023” Per miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtarë 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.
- 4.Projekt vendim për dhënien e shtesës mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin e punonjësve për vitin buxhetor 2024.
- 5.Projekt vendim për rishikim Vkb nr.99 datë 21.12.2023 “ Dhënie në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 67.935 ha “ Për park fotovoltaik “, (stacionet, objektet perkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin, Gjader, Kirë për shkak të ndryshimit të afatit nga “deri në 9 vjet” në “ deri në 10 vjet” dhe zvogëlimit të sipërfaqes nga 67.935 ha në 61.229 ha.
- 6.Projekt vendim për rishikim Vkb nr.100 datë 21.12.2023 “ Dhënie në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 10.246 ha “ Për park fotovoltaik “, (stacionet, objektet perkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin, Gjader, Kirë për shkak të ndryshimit të afatit nga “deri në 9 vjet” në “ deri në 10 vjet”.
- 7.Projekt vendim për dhënien me afat 9 vjet sipërfaqen prej 0.6234 ha “ Për agropylltari në ekonominë pyjore Drin Gjader Kirë”.
- 8.Projekt vendim për dhënien me qira për antenë të telefonisë celulare One Albania të sipërfaqes prej 0.0205 ha dhe për rrugë kalimi 0.4 km nga prona fond “Pyll cungishte” në ngastren nr.131/a në ekonominë pyjore Shllak 1”.
- 9.Projekt vendim për dhënien me qira për antenë të telefonisë celulare One Albania të sipërfaqes prej 0.03 ha dhe për rrugë kalimi 0.311 km nga prona fond “Bimësi pyjore” në ngastren nr.15b në ekonominë pyjore Bushat Bërdicë”.
- 10.Projekt vendim për rishqyrtim vendimi nr.9 datë 26.01.2024 për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 0.6012 ha “ për agropylltari në ekonominë pyjore Drin, Gjader,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kirë për shkak të saktësisë së vendndodhjes së sipërfaqes që do të jepet në përdorim me basenin ujor.

11. Raport mbi punën e Këshillit të Bashkisë për 12 mujorin e vitit 2023.

12. Të ndryshme.

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Shkurt 2024, u zhvillua me datë 27.02.2024 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z. Ardian Çelepja.

Të pranishëm në sallë ishin 21 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z. Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e ditës dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës. Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 21 vota Pro.**

Z. Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e dorëheqjes së anëtarit të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

Z. Ervis Shimaj relaton për këshilltarët se Z. Afrim Kapidanja ka dhënë dorëheqje noteriale nga anëtarë i Këshillit Bashkiak dhe me propozim të komisionit të mandateve, i propozojme anëtarëve të Këshillit Bashkiak miratimin e projekt vendimit. Pyeten këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime. Këshilltarët nuk kishin diçka për të shtuar. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin. **Miratohet me 21 vota PRO.**

Z. Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2024.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj. Elidona Lisi-perfaqesuese e zyrës së ndihmës ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se bazuar në fondet e kushtëzuara për muajin Janar 2024, përfitojnë 133 familje, me 473.784 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Dhjetor 2023 janë shpallur fitues, 1034 familje, me fond 7.906.099 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 474.365 lekë.

Z. Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z. Marin Dodaj: Kërkoj që të shtohet numri i përfituesve nga fondi i kushtëzuar.

Znj. Elidona Lisi përgjigjet: Çdo muaj mund të aplikohet online por duhet që nga kërkuesit të plotësohen kriteret për tu bërë pjesë e kësaj skeme përfitimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 21 vota PRO.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës të miratuar me VKB nr.91 datë 21.12.2023” Per miratimin e Buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtarë 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën për të relatuar Znj.Çuka Babani- përgjegjëse e zyrës së shërbimit social, e cila relaton për këshilltarët se projekt vendimi i mesiperm ka qëllim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2024, për të mbështetur projektin “Shërbim lëvizës në familje, për femijet me aftësi të kufizuar në Bashkinë Vau Dejës”, i cili në kohështrirjen 36 mujore ka vlerë totale 4.206.876 lek me TVSH,nga të cilat kontributi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2024 është 3.630.976 lek me TVSH dhe kontributi i Bashkisë është 575.900 lek me TVSH.Është planifikuar të shpenzohet për burime njerëzore,pajisje dhe furnizime dhe shpenzime për aktivitete(trajnim stafi,naftë karburant).

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 20 vota PRO, 1(një) këshilltarë nuk merr pjesë në votim(Z.Pjetër Lleshi).**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien e shtesës mbi pagë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin e punonjësve për vitin buxhetor 2024.

Z.Ervis Shimaj i jep fjalën për të relatuar nga ana financiare Z.Renato Doda-përgjegjës i zyrës financës i cili spjegon së bazuar ne VKM nr.328 datë 31.05.2023 per klasifikimin e funksioneve, grupimin e njesive te veteqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve te pagave te funksionarëve te zgjedhur e të emëruar, te nepunesve civil e te punonjesve administrativ te njesive te veteqeverisjes vendore me propozim te sektorit te burimeve njerezore është propozuar një shtesë page prej 5000 lek ne muaj punonjesve te IT për punë të vështira.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime. Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 19 vota PRO, 2(dy) këshilltarë nuk moren pjesë në votim(Z.Pjetër Lleshi dhe Z.Florin Tanushi).**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Projekt vendim për rishikim Vkb nr.99 datë 21.12.2023 “ Dhënie në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 67.935 ha “ Për park fotovoltaik “, (stacionet, objektet perkatëse etj) në ekonominë pyjore Drin, Gjader, Kirë për shkak të ndryshimit të afatit nga “deri në 9 vjet” në “ deri në 10 vjet” dhe zvogëlimit të sipërfaqes nga 67.935 ha në 61.229 ha.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Z.Mark Suli-specialist inxhinjer prane zyres se pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili thekson se është marrë vendim nga këshilli Bashkiak për këtë projekt vendim por institucini i prefektit te qarkut, bazuar ne ne shkresen e drejtorise së Basenit Ujor, nuk ka dhënë konfirmim ligjor për vazhdimin e procedurave te metejshme me pretendimin se kjo sipërfaqe toke është afër basenit ujor dhe për këtë arsye, ne kemi bërë zvogelim të sipërfaqes duke ju larguar bregut sipas distancave qe lejohen.Ështe zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit.Për sipërfaqen e mesiperme e cila do ti nënshtrohet procedures se konkurrimit publik, sipas legjislacionit në fuqi është zbatuar VKM nr.748 datë 01.12.2022 “për percaktimin e zonës, distances dhe gjerësisë të brigjeve dhe burimeve ujore”, e cila ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikes III.5, si dhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “ Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.Gjithashtu dhënia në përdorim e kesaj sipërfaqe pyjor do sjell të ardhura vjetore për bashkinë, vleren prej 8.755.747 lek.Gjithashtu kërkohet që të ndryshohet afati i dhënies në përdorim nga 9 vite në 10 vite.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Pjetër Lleshi deklarohet se ne si grup politik jemi dakort në parim për dhënie në përdorim të pronave të Bashkisë por ne rastin konkret ne do të abstenojmë në votim sepse nuk kemi qenë pjesë e dëgjësave publike.

Z.Ervis Shimaj sqaron se për këtë projekt vendim është realizuar dëgjese publike dhe se të pranishmit kanë shprehur dakortësi.

Z.Ardian Çelepija-sekretar i K.B sqaron se njoftimi për realizimin e dëgjësive publike ka qenë i publikuar në WEB-in e Bashkisë dhe e ka pasë mundësinë cilido që të bëhet pjesë e kësaj dëgjese.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro, asnjë votë kundër, 5 vota Abstenim**(Z.Pjeter Lleshi,Z.Florin Tanushi, Z.Marin Dodaj, Znj.Rregjinë Shelqetja, Znj. Vijoleta Markolaj).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Projekt vendim për rishikim Vkb nr.100 datë 21.12.2023 “ Dhënie në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 10.246 ha “ Për park fotovoltaik “, (stacionet, objektet perkatëse etj)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

në ekonominë pyjore Drin, Gjader, Kirë për shkak të ndryshimit të afatit nga “deri në 9 vjet” në “deri në 10 vjet”.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Z.Mark Suli-specialist inxhinjer prane zyres se pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili thekson se është marrë vendim nga këshilli Bashkiak për këtë projekt vendim por institucini i prefektit te qarkut, bazuar ne ne shkresen e drejtorise së Basenit Ujor, nuk ka dhënë konfirmim ligjor për vazhdimin e procedurave te metejshme me pretendimin se kjo siperfaqe toke është afër basenit uJOR dhe për këtë arsye, ne kemi bërë sqarimet ligjore në relacionin bashkëngjitur projekt vendimit që kemi paraqitur për shqyrtim. Për sipërfaqen e mesiperme e cila do ti nënshtrohet procedures se konkurrimit publik, sipas legjislacionit në fuqi është zbatuar VKM nr.748 datë 01.12.2022 “për percaktimin e zonës, distances dhe gjeresisë të brigjeve dhe burimeve uJore”, e cila ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikes III.5, si dhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “ Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytezim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”. Gjithashtu kërkohet që të ndryshohet afati i dhënies në përdorim nga 9 vite në 10 vite.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Roberto Trushi:Vërej se projekt vendimi nuk ka hartë fotografike nga google.

Z.Mark Suli: Bashkëngjitur projekt vendimit keni hartën fragmentale ku ben pjese kjo siperfaqe toke e cila është me koordinatat perkatese.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro, asnjë votë kundër, 5 vota Abstenim**(Z.Pjeter Lleshi,Z.Florin Tanushi, Z.Marin Dodaj, Znj.Rregjinë Shelqetja, Znj. Vijoleta Markolaj).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien me afat 9 vjet siperfaqen prej 0.6234 ha “ Për agropylltari në ekonominë pyjore Drin Gjader Kirë”.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Z.Mark Suli-specialist inxhinjer prane zyres se pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili spjegon për këshilltarët se sipërfaqja e mesiperme do ti nënshtrohet procedures se konkurrimit publik, sipas legjislacionit në fuqi është zbatuar VKM nr.748 datë 01.12.2022 “për percaktimin e zonës, distances dhe gjeresisë të brigjeve dhe burimeve uJore”, e cila ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikes III.5, si dhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “ Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytezim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.Gjithashtu



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

dhënia në përdorim e kesaj sipërfaqe pyjor do sjell të ardhura vjetore për bashkinë, vleren prej 6234 lek.

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se për projekt vendimin e mësipërm është realizuar dëgjese publike me datë 07.02.2024 me banorët e fshatit Stajka, të cilët kishin shprehur dakortesi për projekt vendimin.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro, asnjë votë kundër, 4 vota Abstenim** (Z.Pjeter Lleshi, Z.Florin Tanushi, Znj.Rregjinë Shelqetja, Znj. Vijoleta Markolaj).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien me qira për antenë të telefonisë celulare One Albania të sipërfaqes prej 0.0205 ha dhe për rrugë kalimi 0.4 km nga prona fond “Pyll cungishte” në ngastren nr.131/a në ekonominë pyjore Shllak 1”.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Z.Mark Suli-specialist inxhinjer prane zyres se pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili spjegon për këshilltarët se subjekti One Albania ka pasë kontratë të lidhur me Bashkinë dhe kërkohet rinovimi i sajë. Subjekti ka qenë korrekt me kontraten e mëparshme.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 21 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e nëntë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien me qira për antenë të telefonisë celulare One Albania të sipërfaqes prej 0.03 ha dhe për rrugë kalimi 0.311 km nga prona fond “Bimësi pyjore” në ngastren nr.15b në ekonominë pyjore Bushat Bërdicë”.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Z.Mark Suli-specialist inxhinjer prane zyres se pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili spjegon për këshilltarët se subjekti One Albania ka pasë kontratë të lidhur me Bashkinë dhe kërkohet rinovimi i sajë. Subjekti ka qenë korrekt me kontraten e mëparshme.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 21 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dhjetë të rendit të ditës:

Projekt vendim për rishqyrtim vendimi nr.9 datë 26.01.2024 për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 0.6012 ha “ për agropylltari në ekonominë pyjore Drin, Gjader, Kirë për shkak të saktësisë të vendndodhjes së sipërfaqes që do të jepet në përdorim me basenin ujqor.

Z.Ervis Shimaj fton për të relatuar për projekt vendimin Z.Mark Suli-specialist inxhinjer prane zyres se pyjeve Bashkia Vau Dejës, i cili spjegon për këshilltarët se këshilli bashkiak e ka marrë një herë këtë vendim, po drejtorja e baseneve ujqore është shprehur që kjo sipërfaqe toke është pranë bregut të argjinaturës.Sqarojmë se kjo sipërfaqe toke është në një distancë shumë të largët me argjinaturen e H/C dhe per kete qellim kemi bere sqarimet perkatese ne relacionin bashkengjitur projekt vendimit duke ribërë koordinatat e reja sepse kjo sipërfaqe toke ndodhet pranë asfaltit qe kalon në fshatin Stajka.Per kete arsye kerkojme miratimin e projekt vendimit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Z.Frano Prenga pyet: Me cilat harta punojnë basenet?

Z.Mark Suli pergjigjet:Basenet operojnë me hartat e vjetra te pa azhornuara gjë e cila nuk i pershtatet realitetit, pra është e pakuptimtë pergjigja që ato kthejnë.

Këshilltarët e tjerë nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro, asnjë votë kundër, 5 vota Abstenim**(Z.Pjeter Lleshi,Z.Florin Tanushi, Z.Marin Dodaj, Znj.Rregjinë Shelqetja, Znj. Vijoleta Markolaj).

Pika 11. Raport mbi punën e Këshillit të Bashkisë për 12 mujorin e vitit 2023.

Për këtë pikë të rendit të ditës relaton Z.Ardian Çelepija- sekretar i Këshillit Bashkiak Vau Dejës, i cili pasqyron përpara këshilltarëve punën dhe aktivitetin e këshillit të realizuar gjatë vitit 2023.Konkretisht u raportua vendimmarrja dhe u specifikuan vendimet kryesore, frekuentimi i mbledhjeve nga ana e këshilltarëve,kërkesat dhe ankesat e qytetarëve, konsultimet me publikun, aktivitetet kryesore të këshillit si dhe realizimi i buxhetit të tijë.

Këshilltarët shprehen dakortësi lidhur me raportin e punës 12 mujore të vitit 2023 për K.B Vau Dejës.

Pika 12: Të ndryshme:Këshilltarët nu kishin pyetje apo diskutime për këtë pikë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës e datës 27.02.2024 deklarohet e mbyllur nga kryetari këshillit.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian CELEPIJA



Këshilltarët:

Evis Shinoj
Brendo Prerpa
Jonuzi Hoxha
Kristina Krasni
Neli Kopliani
Besmir Koproj
Ermir Tokiri
Borato Trosh

